

## **MIRGEN PERO**

Mirgen Pero mban pozicionin e Këshilltarit për Komunikimin dhe Mediat në Kabinetin e Ministrit të Drejtësisë që prej muajit Korrik 2023.

Z. Pero ka kryer studimet universitare në Fakultetin e Shkencave Sociale në degën “Sociologji-Filozofi” në vitin 2008 dhe studimet Master në degën “Studime Gjinore dhe Zhvillim”. Karrierën profesionale e ka nisur si gazetar në shtypin e shkruar, duke ndërtuar një portofol pune 10 vjeçare në komunikim dhe media, i aktivizuar si gazetar, redaktor dhe kryeredaktor. Përgjatë viteve 2009-2021, z. Pero ka mbajtur dhe pozicionin e Drejtorit të Marrëdhënieve me Jashtë dhe Komunikimit për Federatën Shqiptare të Boksit, duke u specializuar në komunikimin strategjik, institucional, mediatik dhe marrëdhëniet ndërkombëtare. Për kontributin e tij në fushën e komunikimit, z. Pero është zgjedhur anëtar i Bordit të Komunikimit të institucioneve ndërkombëtare si IBA dhe EUBC përgjatë viteve 2015-2019 dhe rizgjedhur sërish në vitin 2019, duke kontribuar në zhvillimin e strategjive dhe politikave të komunikimit në nivel evropian dhe botëror.

Aktualisht mban pozicionin e këshilltarit të Ministrit të Drejtësisë z.Ulsi Manja.